



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1169/11 Prot.

Durrës, më 26.7 2022

VENDIM

Nr. 34, datë 26.7 2022

"Miratimi i pagesës së orëve mësimore, të realizuar mbi mësimdhënien e normuar vjetore, për vitin akademik 2021-2022, nga personeli akademik me kohë të plotë për pesë fakultetet e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.

Bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 748, datë 11.06.2009, "Për trajtimin me pagë të personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 29 datë 09.10.2018, të ndryshuar, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë", shkresës nr. nr., 1147, 1147/1, 1147/2, 1147/3, 1147/6 datë 18.07.2022, të Drejtorisë së kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë "Për llogaritjet e orëve mësimore të realizuara nga lektorët me kohë të plotë, që kanë zhvilluar mësim në të dy ciklet e studimit në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, për vitin akademik 2021-2022," miratuar nga Zv. Rektori për anën mësimore, shkresën nr. 1147/7 datë 19.07.2022 të Rektorit, shkresën nr. 1147/8, datë 25.07.2022 të Administratorit, relacionin e hartuar nga Drejtoria e Administrimit Financiar, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 26.07.2022,

VENDOSI:

1. Miratimin e pagesës në masën deri në 200 orë mësimore të lejueshme mbinormën mësimore vjetore për orë mësimore të realizuara brenda auditorit, për vitin akademik 2021 – 2022, për personelin akademik me kohë të plotë, për pesë fakultetet e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas Udhëzimit nr. 29 datë 09.10.2018, të ndryshuar, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë".
2. Miratimin e pagesës mbi limitin 200 orë mësimore deri në 300 orë mësimore të realizuara në auditor, si orë mësimore suplementare të realizuara brenda auditorit, për vitin akademik 2021 – 2022 për personelin akademik me kohë të plotë për pesë fakultetet e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, vetëm në rastet specifike pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues, propozimit të drejtuesit të Njesisë bazë dhe miratimit nga drejtuesi i Njesisë kryesore.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

- Administratori
- Drejtoria e Administrimit Financiar
- Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Kryetar i Bordit të Administrimit

Adi ALIAJ

